



POP 5

1 Reklamë në Kuvendin e Rinor, demokrat shpirtin në qeshur Berisha dhe Ramiza Goxhi: Fajet i ka shprehur! Të mos e bëjë në një qesh.

2 Berisha paralajmëron Ramën: Mos gabo të kërkesësh drejtimin në një ministër nga rruga eungandë! Nuk mund të spostosh as diçka fotografik, as tërësisht.

3 Premtimi i Vuçiq: Njëra për prishjen e maknash pranon të investojë në Serbi, do të luftojmë me kostum në pajanë.

4 'Pak bukë e sheqer', jeta e 50-vjeçarit në Katundin e vjetër të Mirditës: Vuajtje në të madhe nuk ka, shteti të më ndihmojë.

5 Sot ka bërë atentat në Lezhë, del FOTO kush është 28-vjeçari nga Milioti që sapo ishte kthyer nga Belgjika.

Kronikë

'Ik shko futu te lokali', Report Tv siguron videon pak pas atentatit dje në Lezhë, Blerim Preçi pyet në gjendje të traumatizuar: A kam plumba në kokë?

'A kam plumba në kokë?' Ky është reagimi i parë i Blerim Preçit, pak pas atentatit ndaj tij një ditë më parë në Lezhë. Report Tv ka siguruar videon pak pasi i riu bashkë me kushërinin e tij, i kishin shpëtuar mrekullisht plumbave! **Shoqërohen 10 persona! Zbardhet dëshmia e të rrit: Nuk kam konflikte**

- Atentati ndaj Blerim Preçit në Lezhë, shoqërohen 10 persona, flet 28-vjeçari: Nuk kemi konflikte
- Lezhë/ Plumba 28-vjeçarit nga Milioti, sapo ishte kthyer nga Belgjika! U hodh nga makina kur kuptoi që po i bëhej atentat! Report Tv sjell videon pak minuta pas sulmit



Redaksia 15 Maj, 08:26 | Përditësimi i fundit: 15 Maj, 11:25



LEZHË- 'A kam plumba në kokë?' Ky është reagimi i parë i Blerim Preçit, pak pasi i shpëtoi atentatit një ditë më parë në Lezhë, i cili në gjendje të rëndë psikologjike pyet nëse është plagosur apo jo. Gazetari i Report Tv, Elvis Hila ka siguruar videon pak pasi i riu bashkë me kushërinin e tij, Klisman Preçi, i kishin shpëtuar mrekullisht plumbave, që u shkrepën në drejtim të makinës Mercedes Benz tip 'ML' me të cilën po udhëtonin.

Sic shihet në video, Blerim Preçi del i traumatizuar nga makina dhe qytetari dëgohet teska këshillon 28-vjeçarin që të futet në lokal, ndërsa ka telefonuar ambulancën dhe policinë. Ngjarja e rëndë ndodhi dje në Ishull-Lezhë, ku 28-vjeçari **Blerim Preçi** nga Milioti i cili po udhëtonte bashkë me kushërinin e tij, ranë pre e një atentati, ndërsa ende nuk ka asnjë autor të identifikuar.



LEXO EDHE: **Berisha në Lezhë, vijon sulmet për Yuri Kim dhe Sorosin: Kërkonin të mos kishte opozitë në Shqipëri! Rama të mos gabojë që të lëvizë rrugën tonë drejt BE**

Gjatë natës policia ka ushtruar kontrollë në zonën e bregut të Matës dhe fshatrat e Kurbinit, por pa arritur të bien në gjurmët e atentatorëve të cilët pas ngjarjes, u larguan përgjatë superstradës në drejtim të Miliotit. Gjithashtu janë shoqëruar dhe marrë në pyetje mbi 10 persona, por deklarimet e tyre nuk e kanë ndihmuar grupin hetimor për zbardhjen e ngjarjen dhe ata janë lënë sërish të lire. Sipas burimeve në dëshminë e tyre para hetuesve, Blerim dhe Klisman Preçi kanë deklaruar se nuk kanë konflikte, ndërsa dyshimet janë se shënjestër e atentatit të ketë qenë 28-vjeçari Blerim Preçi i cili sapo ishte kthyer nga Belgjika.

Si ndodhi ngjarja?

Report Tv mëson se në lëvizje e sipër, një Audi gri u është afruar në parakalim dhe një person nga sedilia e pasme qëlloi me pistoletë ndaj makinës së tyre. Dyshohet se autorët i kanë ndjekur dy kushërinjtë Preçi, derisa u janë afruar dhe qëlluan. Sipas dëshmtarëve, Blerim Preçi, që ishte në timon, u hodh nga makina në lëvizje, e cila me pas devijoi dhe doli nga rruga. Ndërsa kushërii i tij mbeti në makinë, ku ishte i ulur në sediljen e parë. Asnjë nga dy kushërinjtë nuk është plagosur nga të shtënat me armë, megjithëse disa plumba kanë goditur makinën e tyre sidomos në pjesën e përparme.

Kush është shënjestra, Blerim Preçi?

Nga informacionet paraprake, 28-vjeçari kishte pak ditë që ishte kthyer nga Belgjika dhe një nga listat kryesore në të cilën po heton policia është pikërisht e shkuara e tij dhe aktiviteti i tij jashtë vendit, teksa nuk ka precedentë penale në Shqipëri. Policia ka ngritur pika kontrolli si dhe po bëhet krehja e zonës me qëllim kagjen e autorëve, për të cilët nga sa mësohet janë larguar me shpejtësi në drejtim të Lagës me njërin tip 'Audi' ngjyrë gri. Në vendin e ngjarjes u sekuestruan rreth 15 gëzhoja, ndërsa janë marrë dhe do të analizohen kamerat e sigurisë të bizneseve në zonë të cilat mendohet se kanë filmuar makinën e autorëve.



Videaja pak minuta pas atentatit, Blerim Preçi në gjendje të traumatizuar

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 10:27 Atentati ndaj Blerim Preçit në Lezhë, shoqërohen 10 persona, flet 28-vjeçari: Nuk kemi konflikte



Atentati me armë zjarri i një nate më parë në Lezhë ndaj kushërinjve Preçi nga Milioti, vijon të mbetet pa autor. Gjatë natës policia ka ushtruar kontrollë në zonën e bregut të Matës dhe fshatrat e Kurbinit, por pa arritur të bien në gjurmët e atentatorëve të cilët pas ngjarjes, u larguan përgjatë superstradës në drejtim të Miliotit. Gjithashtu janë shoqëruar dhe marrë në pyetje mbi 10 persona, por deklarimet e tyre nuk e kanë ndihmuar grupin hetimor për zbardhjen e ngjarjen dhe ata janë lënë sërish të lire.

Sipas burimeve në dëshminë e tyre para hetuesve, Blerim dhe Klisman Preçi kanë deklaruar se nuk kanë konflikte, ndërsa dyshimet janë se shënjestër e atentatit të ketë qenë 28-vjeçari Blerim Preçi i cili sapo ishte kthyer nga Belgjika. Pista kryesore e hetimeve është përqendruar tek e shkuara e tij dhe të vëllait në vendet e Bashkimit Evropian, por pa përjashtuar edhe ndonjë konflikt të mundeshëm në vendin tonë



M.Q./KT/Shqiptarja.com

TAG: **Klisman preci** **Lezhe** **blerim preci** **atentat blerim preci**

Komente

Gripit: 15/05/2022 15:56
Asgjë nuk e justifikon tentativën për marrjen e jetesë këtij djali, vetëm nese eshte perfaqshire vete ne ngjarje te tilla. Policia duhet ta zbardhe kete ngjarje ne menyre qe te keputet zinxhiri i vrasjeve. Pasdori ekstreme. Vijnë ti lajne hesapet ketu se andej i zbulojne dhe marrin denimin qe meritojne. Ketu eshte kaos.

Scutari: 15/05/2022 15:54
Këta janë trimat pra që në ambiente publik ndaj njerëzve të thjeshtë bëjnë si të fortë! Shihen si mos e ka bërë edhe në turrë ...

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: A duhet të hetohen gjyqtarët e prokurorët e shkarkuar nga Vettingu?

PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë

Dy aksidente brenda disa minutash në Lezhë! Humbi kontrollin dhe i ra shtyllës me motor, ndërron jetë polici i burgut të Shënkolitit Parakalim i gabuar, plagosen dy persona të tjerë (VIDEO)

15 Maj, 16:40

Sociale

'Pak bukë e sheqer', jeta e 50-vjeçarit në Katundin e vjetër të Mirditës: Vuajtje më të madhe nuk ka, shteti të më ndihmojë

15 Maj, 16:08

Politikë

Elezzi nga Laçi: Kishte axhendë tjetër! Në 2018 kuksianët janë tradhëtuar nga Flamur Noka! Bëri fushatë me Berishën 'mbi kokë'

15 Maj, 14:34

Kultura

Besimtarët katolikët kremtojnë festën e Shën Lezhërit

15 Maj, 11:01

Kronikë

Lezhë/ Plumba 28-vjeçarit nga Milioti, sapo ishte kthyer nga Belgjika! U hodh nga makina kur kuptoi që po i bëhej atentat! Report Tv sjell videon pak minuta pas sulmit

14 Maj, 20:15

Sociale

Hera e dytë brenda një muaji! Të futura në një thes, gjenden sërish pula të ngordhura të Rana e Hedhun! Pushuesit: Duhet të merren masa (VIDEO)

14 Maj, 15:20

Kronikë

Prokuroria mbyll hetimet për Edmond Përdodën, i akuzuar për vrasjen e rapsoitit dhe mikut të tij në Lezhë! Dy javë më parë vëllai i tij u dënua me burgim të përjetshëm

14 Maj, 09:31

Kultura

Nis restaurimi i kishës së Kuvendit të Arbrit të vitit 1703 në Lezhë! Do të kthehet në atrakcion turistik

12 Maj, 19:28

Kronikë

Përplasen dy automjete në Lezhë, dy të plagosur, njëri prej shoferëve në gjendje të rëndë, po transmetohet drejt Traumës

11 Maj, 21:35

Kronikë

Lezhë, makina del nga rruga dhe përfundon në një tokë, 4 të plagosur, dy në Lezhë! Dy javë më parë vëllai i tij u dënua me burgim të përjetshëm

11 Maj, 07:56

Kronikë

Aksident rrugor në autostradën Lezhë-Laç, përplasen 3 makina! Plagoset 1 grua dhe 1 fëmijë

10 Maj, 16:25

Kronikë

Spanja e kërkon për 40 vjetdhje me dhunë, Gjykata e Kurbinit të në burg për 40 ditë drejtorin e Ujësëllësit! Pritet ekstradimi

10 Maj, 09:54